

Me rastin e 95 vjetorit të lindjes, 1909-2004

# KONTRIBUTI I SELMAN RIZËS NË FUSHËN E GRAMATIKËS KONTRASTIVE

Agim Spahiu

qershor 2004

## Përmbledhje

Në këtë shkrim flitet për kontributin e prof.Selman RIZËS në fushën e gramatikës kontrastive. Aty vihet në spikamë një gramatikë e tij e njohur e gjuhës serbokroate, por për nxënës është shtjelluar në gjuhën shqipe. Artikullshkruesi e vështron këtë Gramatikë nga dy anë: Nga ana përmbajtësore-teorike dhe terminologjike. Ai vjen në përfundim se kjo Gramatikë, edhe pse është shkruar para 50 vjetësh, është e një niveli të duhur shkencor, prandaj s'ka dyshim se edhe sot hartuesit e teksteve gramatikore mund të mbështeten në të, duke marrë për bazë diçka nga ajo.

**Selman RIZA**, për mendimin tonë, ishte njëri prej gjuhëtarëve më të mëdhenj shqiptarë të shekullit XX. Ai ka lënë pas vetes një opus të gjerë i cili edhe sot e kësaj dite meriton të analizohet e të vështrohet nga shumë anë e aspekte. Por ne në këtë shkrim do të ndalemi vetëm në një segment të tij dhe pikërisht në KONTRIBUTIN që ka dhënë ai NË FUSHËN GRAMATIKËS KONTRASTIVE.

Në vitin 1952 **Riza** ka botuar tekstin shkollor **GRAMATIKË TË SËRBO - KROAT-ISHTES**, që, për mendimin tonë, është njëra prej gramatikave më të mira shkollore të kohës. Themi kështu për arsye se edhe sot pas gjysmë shekulli, po të shikohet me një sy pak kritik, në të mund të gjejmë shumë gjëra të vlefshme e të qëndrueshme. Prandaj cilido studiues shqiptarë që merret sot me çështje të ndryshme të fonetikës e të gramatikës së shqipes, nuk bën të anashkalojë këtë gramatikë, pavarësisht prej asaj se ka të bëjë me një gjuhë sllave. Aty do të gjejmë shumë mendime të vlefshme, zbërthime e sistemime që janë aktuale e të qëndrueshme edhe sot e gjithë ditën.

Kjo **Gramatikë** është kontrastive, ngasë çdo gjë që thuhet a shpjegohet në këtë gjuhë fqinjë, krahasohet me sistemin fonetik e gramatikor të gjuhës sonë, duke i nxjerrë në shesh kështu pikëpërkimet e pikëdallimet në mes tyre. Është një gramatikë e hartuar me një akribi të veçantë shkencore dhe kjo ka bërë që t'i tejkalojë edhe shumë të tjera të asaj periudhe, madje edhe disa të mëvonshme.

Në këtë trajtesë do të ndalemi kryesisht në disa çështje teorike dhe terminologjike të saj.

Lidhur me aspektin e parë, është mirë të ndalemi pak te kriteret e aplikuar në klasifikimin e pjesëve të ligjëratës: Dhe fillimisht mund të konstatojmë se çështja e numrit të pjesëve të ligjëratës, në përgjithësi, në gjuhën tonë, por edhe në shumë gjuhë të tjera, me gjithë disa studime të bëra<sup>1</sup>, edhe sot e kësaj dite nuk ka pasur ndonjë zgjidhje përfundimtare. Vështirësitë janë të shumta nga vetë fakti se kategoritë leksiko - gramatikore në cilëndo gjuhë, pra edhe në gjuhën tonë, janë shumë heterogjene. Prandaj për studuesin e tyre kërkohet një përpikëri më e madhe në çështjen e zbatimit të kriterit bazë ose të kriterëve bazë të gërshetuara. Pra është një çështje që kushtëzohet nga kriteret mbizotëruese.

Në klasifikimin e pjesëve të ligjëratës, sipas mendimit tonë, **Selman Riza** e ka favorizuar kriterin gramatikor a sintaksor, në përgjithësi, kriter ky që në vitet e fundit është kudo mbizotërues në gramatikat e gjuhëve të huaja<sup>2</sup>. Por kjo nuk do të thotë se kriteret e tjera duhet të lihen anash, ngase vetë kompleksiteti i tyre kërkon një gërshetim të domosdoshëm kriteresh. Në këtë **Gramatikë** Selman Riza i ka pranuar 11 pjesë të ligjëratës, çka do të thotë se edhe nyjën e ka konsideruar si pjesë të veçantë të ligjëratës. Këtë klasifikim e gjejmë edhe te O. Myderrizi, K. Cipo, Sh. Demiraj etj. Pa u futur edhe shumë në detaje, po i japim këtu edhe disa vlerësime në pika të shkurtra lidhur këtë çështje: Në këtë **Gramatikë** gjejmë një klasifikim shumë të drejtë të përemrave. Ata i ka ndarë në dy grupe: Në **PËREMËNA** dhe në **PËREMËNORË**. **PËREMËNAT**, sipas tij, janë zëvendësuese emrash, kurse **PËREMËNORËT** zëvendësuese ndajemënash, numërorësh dhe emrash, por që për kah trajta janë ndajemëna<sup>3</sup>. Po kështu, numërorët rreshtorë ose numërorët rendorë, siç i quante ai, i ka konsideruar si ndajemra<sup>4</sup>, meqë u përshtaten emrave në numër, gjini dhe rasë; Po të ndalemi te zberthimet e disa pjesëve të ligjëratës në këtë **Gramatikë**, do të shohim se shumë klasifikime dhe shpjegime mund të jenë të qëndrueshme dhe aktuale edhe sot. Kështu, p. sh., klasifikimi i mbiemrave në cilësorë dhe lëndorë - përkatësorë<sup>5</sup>, na duket se është më i qëndrueshëm dhe më i drejtë sesa klasifikimi i ekzagjeruar në: Mbiemra cilësues të drejtpërdrejtë dhe cilësues të ndërmjetuar (a marrëdhëniorë), të cilin e ndeshim sot në **Gramatikën e gjuhës shqipe 1** të ASHSH - së, (botimet e viteve 1976, 1995 dhe 2002); Aty do ta gjejmë edhe trajtimin i fjalëzave: po (të pohimit), jo (të mohimit) dhe ndoshta/ mbase, simbas gjasës (të dyshimit), si ndajfolje, siç veprojnë sot shumë gramatikanë të huaj<sup>6</sup> etj.

<sup>1</sup>Shih F. Agalliu, *Mbi pjesët e ligjëratës në gjuhën shqipe*, në *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme*, Tiranë, 1972.

<sup>2</sup>Shih për këtë gjë gramatikat e gjuhës frënge: Grevisse § Goosse; *Nouvelle grammaire Française*, ed. 3., De Boeck § Ducult, 1995; M. Riegel, Jean - Christophe Pellat - Rene Rioul, *Grammaire methodique du française*, Manuel, ed. 3. Paris, 2003; Në gjuhën gjermane: L. Götze, Ernest W. B. Hess - Lüttich, München 1999; Helbg/Buscha, *Deutsche Grammatik*, 1999 etj.

<sup>3</sup>S. Riza, *Gramatikë e sërbo - kroatishtes*, Prishtinë, 1952, f. 376, 386.

<sup>4</sup>Mbiemrat i quan NDAJËMËNA, f. 386, 415 etj.

<sup>5</sup>Shih po aty, f. 362.

<sup>6</sup>Shumë autorë si: R. Bergentoft, M. Nord, S. Nord, *Grammaire française communicative*, Heidelberg, 1998, f. 126/127; M. Grevisse, *Le bon usage*, Klett/Ducolot, 1980; J. Hass § D. Trac, *Französische Grammatik*, 1983, 76; C. E. Eckersley, *A Concise English Grammar for foreign students*, Logman,

Në fushën e sintaksës ai ka pasur qysh atëherë koncepte të qarta të dallimit të fjalive nga aspekti logjik, gramatikor dhe gramatikor - logjik. Vështrimi i fjalive nga këto anë e ka shtrënguar këtë studiues që të krijojë edhe disa nocione të reja që deri atëherë nuk i kishim pasur, si p. sh. i përtukallxuesi a predikandumi, ana a jekti<sup>7</sup>. Po kështu na duket një mendim i drejtë i tij kur gjymtyrën e përcaktorit a të caktuesit, siç i thoshte ai, e ka konsideruar si një nëngjymtyrë të gjymtyrëve të ndryshme të fjalisë si p. sh: të përtukallxuesit, të kallxuesit, të ndënanës, të kundranës së drejtë e të zhdrejtë dhe të çdonjërës prej rrethanave të llojllojshme<sup>8</sup> etj.

Sa i përket aspektit të dytë, pra **terminologjisë gjuhësore**, do shtuar se në këtë **Gramatikë** ka shumë terma gramatikorë që ai i përdorte në në atë kohë dhe që meritojnë të përdoren edhe në ditët e sotme, por që, për fat të keq, nuk arritën të përgjithësohen e të futen në përdorim në tekstet e mëvonshme gramatikore e gjuhësore. Mirëpo edhe sot nuk është vonë që disa terma të rivështrohen nga shumë anë dhe ata që na duken më të qëlluar, më të gatitur gjuhësisht të futen gradualisht në përdorim. Këtu, për mendimin tonë, janë për t'u parë fjalëtermat si: **NDAJEMN (R) I, KRYEFJALIA** dhe **NËNFJALIA**.

Përdorimin e termit **NDAJEMËN** Selman Riza e ka arsyetuar mjaft bindshëm në këtë tekst kur thotë se, po të mbështetemi mbi bazën e latinizmave: adjektiv dhe adverb, në gjuhën tonë do të duhej të kishim: NDAJEMËN dhe NDAJFOLJE, sepse *ad* nuk është *mbi* në gjuhën tonë, por *ndaj*. Prandaj, përfundon ai, ose duhet të kemi MBIEMËR dhe MBIFOLJE ose siç është më drejt NDAJEMËN dhe NDAJFOLJE<sup>9</sup>. Pra, është një vërejtje shumë me vend. Ndërsa me futjen e termave KRYEFJALI dhe NËNFJALI Selman Riza ka bërë përpjekje qysh atëherë të bëjë një dallim nocionor në mes fjalisë kryesore a drejtuese dhe fjalisë e varur, dallim të cilin e bëjnë vazhdimisht gramatikanët dhe studiuesit e gjuhës frënge, angleze etj. Kështu p. sh. në gjuhën frënge të gjitha njësitë sintaksore që përbëjnë një tërësi të vetme kuptimore, gramatikore dhe intonacionore (intonacioni i tyre i përmbartimit është elementi më i rëndësishëm i fjalisë), quhen fraza (La phrase), ndërsa njësitë e tjera që nuk i kanë këto elemente, por që janë vetëm pjesë e tyre, sepse kanë nga një bërthamë kallzuesore të pranishme ose të nënkuptueshme, (zakonisht nuk e kanë intonacionin e vet të përmbartimit), quhen propozicione (Les propositions). Edhe në gjuhën angleze bëhet dallim i Sentencës (Sentece), në njërën anë, dhe i klauzës (clause), në anën tjetër. Prandaj edhe në gjuhën tonë është mirë të bëhet sot ky dallim nocionor, ngase për termat: **Phrase** dhe **Sentence** ne në gjuhën tonë tashmë e kemi emërtimin e bukur FJALI, ndërsa termave propozicion dhe klauzë mund t'u përgjigjej për mrekulli termi **NËNFJALI** të cilin e ka përdorur Selman Riza në këtë tekst shkollor, por edhe në studimet e tij të shumta gjuhësore, për të shënuar atë njësi sintaksore që ne zakonisht e gjejmë si fjali e varur ose si pjesë e nënrenditur e fjalisë së përbërë. Sepse fundja ky ishte

---

1985, f. 21 etj., këto fjalëza i trajtojnë si ndajfolje. Por ka edhe autorë gjermanë e frëngë që këto ndajfolje i konsiderojnë si ekuivalente fjalish, i p. sh. Die Grammatik, 4, Duden, 1998, f. 620; G. Helbig, Deutsche Grammatik, 1996, 105 etj; M. Grevisse §A. Goosse, *Nouvelle grammaire française*, bot. 3. 1995, f. 345 etj.

<sup>7</sup>S. Riza, Vepra e përmendur, f. 502 - 507.

<sup>8</sup>Po aty, f. 510.

<sup>9</sup>Po aty, f. 362.

edhe synimi i tij. Edhe emërtimi **KRYEFJALI** është një term i ri i krijuar nga Selman Riza, i cili i përgjigjet shumë mirë emërtimit **FJALI KRYESORE a DREJTUESE** (ang. Main clause).

**Selman Riza** kishte krijuar edhe terma të tjerë si: **KUNDRANË e KUNDRA-NOR**. Këta terma Riza thoshte se mund të përdoren për analogji me termat: **RRETHANOR dhe NËNANOR**. Mirëpo ky i fundit ka mbetur përgjithësisht në shtresën pasive të përdorimit, meqenëse asnjëherë nuk ka arritur ta zëvendësojë termin **KRYEFJALË** që tashmë e ka marrë dhënë në përdorim. Ndërsa termin **KUNDRANOR** e parapëlqen të përdorë edhe R. Përnaska në studimet e tij të mëvonshme<sup>10</sup>.

Këto qenë vetëm disa të dhëna të pakta të cilat i veçuam nga kjo **Gramatikë** e suksesshme kontrastive, hartuar nga albanisti i shquar **Selman RIZA** në këtë përvjetor të lindjes së tij. Ky studiues ka pasur pa dyshim rezultate edhe në fusha të tjera studimore, si p. sh. në histori të gjuhës e në gramatikë historike, në etimologji, në tekstologji etj., për të cilat fusha studiuesit e sotëm kompetentë mund t'i shfaqin mendimet dhe vlerësimet e veta.

---

<sup>10</sup>Shih R. Përnaska, *Kundranori me parafjalë në gjuhën e sotme shqipe*, Dukagjini, Pejë, 1996.